



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, MBROJTJE DHE SHPËTIM

Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, NR.03/L-040, bazuar në Rregulloren për taksa, tarifa dhe gjoba komunale, të datës 29 prill 2010, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim shpall:

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë pronarët e biznese, të cilët i shfrytëzojnë hapësirat publike për vendosjen e tavolinave shërbyese para lokaleve të tyre, të paraqesin kërkesën për marrje të lejeve për shfrytëzim të përkohshëm, gjatë sezonit veror.

Kërkesës i bashkëngjitet:

- Certifikata e biznesit
- Skica me dimensionet e hapësirës për shfrytëzim
- Kopja e letërnjoftimit

I paralajmërojmë të gjithë pronarët e shfrytëzimit të hapësirave publike për veprimtari hoteliere se, në rast të mospajisjes me leje, në vazhdimësi do të ndërmerren masa parandaluese dhe ndëshkimore ndaj tyre.

Afati për aplikim është deri më 21.03.2014

Kërkesat pas afatit të paralajmëruar nuk do të merren në shqyrtim.

Kërkesa dorëzohet në Administratën komunale, përkatësisht në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve, Zyra nr 14.

Podujevë
10.03.2014

Drejtori
Faik Muçiqi